



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Mësimdhënies Lëndore

Me datë 24.9.2021

Vendimet për DISKUTIM PUBLIK					
#	Kandidati	Specializimi	Tema e punimit	Komisioni	
1	Aida Dula	Mës. Fizikë	Rëndësia e zgjidhjes së detyrave numerike nga optika gjeometrike në SHMU	Kryetar/e	Ruzhdi Kuqi
				Mentor/e	Zeqir Shaqiri
				Anetar/e	Rozafa Ferizi
2	Muhamet Kastrati	Mës. Fizikë	Roli i zgjidhjes së detyrave numerike në të nxënit e fizikës në shkollat e mesme të larta	Kryetar/e	Zeqir Shaqiri
				Mentor/e	Sadik Bekteshi
				Anetar/e	Vlora Sylaj
3	Gëzim Sahitaj	Mës. Gjeografi	Gjendja e shkollave të komunës së Rahovecit me kabinete dhe rëndësia e tyre në lëndën e Gjeografisë	Kryetar/e	Atdhe Hykolli
				Mentor/e	Nusret Pllana
				Anetar/e	Arlinda Beka
4	Arbenita Rushiti	Mës. Matematikë	Ndikimi i argumentimit të zgjidhjeve të detyrave për përmirësimin e arritjeve të nxënësve në lëndën e matematikës	Kryetar/e	Fatlume Berisha
				Mentor/e	Eda Vula
				Anetar/e	Fahri Marevci
5	Hava Ibrahim	Mës. Matematikë	Aplikimi i metodës tradicionale dhe i matematikës realiste në mësimdhënien e sistemeve të ekuacioneve lineare me dy të panjohura	Kryetar/e	Fahri Marevci
				Mentor/e	Xhevat Krasniqi
				Anetar/e	Vlora Sylaj
6	Fitore Kryeziu	Mës. Biologji	Qëndrimet e nxënësve mbi formën individuale të mësimin në përvetësimin e përmbajtjeve në lëndën e biologjisë	Kryetar/e	Islam Krasniqi
				Mentor/e	Ruzhdi Kuqi
				Anetar/e	Zeqir Veselaj
7	Xhevdie Kurteshi	Mës. Biologji	Ndikimi i metodës së demonstrimit në të nxënit e lëndës së biologjisë	Kryetar/e	Zeqir Veselaj
				Mentor/e	Ruzhdi Kuqi
				Anetar/e	Ganimete Kulinxha
8	Besnik Latifi	Mës. Tekn.TIK	Aplikimi i softuerëve "Open Source" për përfitimin në të nxënit në shkollat e mesme të Prishtinës	Kryetar/e	Kastriot Buza
				Mentor/e	Sylejman Berisha
				Anetar/e	Vjollca Ahmeti
9	Doruntina Luta	Mës. Tekn.TIK	Roli i eksperimentit virtual në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë në Shkollat e mesme të ulta	Kryetar/e	Florent Bunjaku
				Mentor/e	Sylejman Berisha
				Anetar/e	Minevere Rashiti

10	Emire Biçkaj	Mës. Matematikë	Ndikimi i mësimit virtual në motivimin e nxënësve për punë të pavarur	Kryetar/e	Kyvete Shatri
				Mentor/e	Eda Vula
				Anetar/e	Hatixhe Ismajli
11	Amir Gashi	Mës. Biologji	Qëndrimet e nxënësve të klasave të XI-ta për efikasitetin e mësimit online në lëndën e Biologjisë gjatë pandemisë Covid-19	Kryetar/e	Kyvete Shatri
				Mentor/e	Zeqir Veselaj
				Anetar/e	Vlora Sylaj
12	Arian Arifi	Mës. Biologji	Ndikimi i teknologjisë informative në përvetësimin e të nxënësve në lëndën e Gjeografisë	Kryetar/e	Zeqir Veselaj
				Mentor/e	Nusret Pllana
				Anetar/e	Kyvete Shatri
13	Gentiana Nebihu	Mës. Gjeografi	Strategjitë e mësimit që kontibujojnë në zhvillimin e kompetencës së të mësuarit tek nxënësit dhe sfidat në zhvillimin e saj	Kryetar/e	Bahtije Gërbeshi
				Mentor/e	Nusret Pllana
				Anetar/e	Minevere Rashiti
14	Lediana Shala	Mës. Tekn.TIK	Përdorimi i veglës Pear Deck për realizimin e prezantimeve interaktive në lëndën e Teknologjisë	Kryetar/e	Florent Bunjaku
				Mentor/e	Kyvete Shatri
				Anetar/e	Teuta Danuza

Kandidati/ja: 1. Aida Dula

Tema: Rëndësia e zgjidhjes së detyrave numerike nga optika gjeometrike në SHMU

ABSTRAKTI

Duke ditur lidhjet e ngushta të fizikës me matematikën si dy degë të shkencave natyrore dhe duke pasur parasysh se vështirësitë e nxënësve në të nxëniet e lëndës së fizikës është problem serioz dhe i pashmangshëm atëherë është parë me arsye të hulumtohet rëndësia e zgjidhjes së detyrave numerike në mësimin e fizikës konkretisht në degën e optikës gjeometrike.

Nxitja dhe kureshtja për të punuar e hulumtuar rreth kësaj problematike në fjalë është sqarimi i koncepteve të ligjeve të fizikës me përdorimin e formulave konkretisht me zgjidhjen e detyrave numerike.

Pyetja e këtij hulumtimi është: Cila është rëndësia e zgjidhjes së detyrave numerike në të mësuarit e optikës gjeometrike?

Realizimi i hulumtimit është bërë me nxënësit e klasave të nënta të tri shkollave. Pra pjesëmarrës ishin: SHMU “Skender Kastrati” – Radoste, SHMU “Isa Boletini” – Rahovec dhe SHMU “7 Shtatori” – Rahovec, gjithsej 64 nxënës.

Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur metodologjia mikse.

Grumbullimi i të dhënave është i natyrës primare, sepse mbledhja e këtyre të dhënave është e bazuar në pyetësorë në formë të testit që është realizuar me nxënës. Mbledhja e të dhënave është bërë me pyetësorë të strukturuar dhe të përgatitur për këtë qëllim i cili do të jetë plotësisht anonim.

Duke u bazuar në rrjedhën e planifikimit dhe organizimit të hulumtimit synohet që të nxirren rezultatet racionale mbi rëndësinë e zgjidhjes së detyrave numerike, pra nxënësit të mos mësojnë vetëm pjesën teorike nga lënda por me anë të formulave të ligjeve fizike të bëjnë zgjidhjen e detyrave numerike në optikën gjeometrike.

Fjalët kyçe: detyra numerike, fizika, matematika, optika gjeometrike, rëndësi.

Kandidati/ja: 2. Muhamet Kastrati

Tema: Roli i zgjidhjes së detyrave numerike në të nxënit e fizikës në shkollat e mesme të larta

ABSTRAKTI

Qëllimi i hulumtimit është të analizojë efektin e detyrave numerike në përforcimin e përmbajtjeve mësimore të fizikës nga nxënësit. Hulumtimi është kuazi-eksperimental me grup kontrolli dhe grup eksperimental. Mostra përbëhet nga 205 nxënës të klasës së X-të, drejtimi i shkencave natyrore të Gjimnazit “Hamdi Berisha” në Malishevë. Në grupin e kontrollit ishin 101 nxënës, kurse në grupin eksperimental 104 nxënës. Metoda e mbledhjes së të dhënave ishte sasimore (kuantitative). Instrumentet për mbledhjen e të dhënave ishin: Pyetësi për nxënës dhe Testi i Njohurive. Pyetësi kishte 8 kërkesa. Testi i Njohurive kishte 10 kërkesa dhe u parashtrua si paratest dhe pastest. Kohëzgjatja e hulumtimit ishte 9 javë. Përgjatë kësaj kohe, me grupin eksperimental u punuan detyra numerike duke zbatuar metoda dhe teknika për lehtësimin e procedurës së zgjidhjes së detyrave numerike nga nxënësit. Kurse, me grupin e kontrollit u punua në aspektin teorik, me zgjidhje të detyrave më të thjeshta, pa sqarime dhe interpretime të këtyre detyrave. Rezultatet e fituara u analizuan dhe u diskutuan hollësisht. Gjetjet e hulumtimit na tregojnë se zgjidhja e detyrave numerike ngrit nivelin e përvetësimit të përmbajtjeve mësimore të fizikës nga nxënësit.

Fjalët kyçe: detyra numerike, fizika, nxënësit, të nxënit, zgjidhja.

Kandidati/ja: 3. Gëzim Sahitaj

Tema: Gjendja e shkollave të komunës së Rahovecit me kabinete dhe rëndësia e tyre në lëndën e Gjeografisë

ABSTRAKTI

Lënda e Gjeografisë është një lëndë shumë e rëndësishme, pasi ajo thuhet se integron në vete shumë lëndë tjera. Kjo lëndë u ofron nxënësve shumë përparësi, si: njohja e botës që i rrethon ku përfshihet natyra, shtetet, kontinentet, etj.; njohja e dukurive natyrore, ndryshimeve klimatike, orientimi në hapësirë etj. Pavarësisht këtyre përparësive që ofron lënda e Gjeografisë, shpeshherë ajo bëhet edhe monotone dhe vështirë e kapshme për nxënësit pikërisht sepse mësimdhënësit nuk arrijnë të përdoren teknikat dhe mjetet e duhura që këtë lëndë ta bëjnë atraktive për nxënësit. Në mesin e arsyeve pse lënda e Gjeografisë mund të konsiderohet monotone nga ana e nxënësve është edhe mungesa e kabineteve, që ka qenë fokus i punimit.

Në këtë hulumtim, krahas aspektit teorik të trajtimit të kabinetit dhe rëndësisë së tij në lëndën e Gjeografisë, është zhvilluar hospitimi me 25 shkolla filllore dhe të mesme në Komunën e Rahovecit për të parë gjendjen e kabineteve në këto shkolla, si dhe hulumtimi me 100 nxënës dhe 30 mësimdhënës prej këtyre shkollave për të marrë perceptimet mbi rëndësinë e kabinetit, mënyrën si përdoret dhe përparësitë që ai sjell në mësimdhënien dhe nxënien në lëndën e Gjeografisë. Rezultatet treguan se gjendja me kabinete në Komunën e Rahovecit nuk është e mirë. Prej 25 shkollave, vetëm 3 kanë kabinet të Gjeografisë. Këto kabinete nuk i plotësojnë shumë prej kushteve minimale të një kabineti standard. Mungojnë shumë prej pajisjeve për mësim dhe ato ekzistueset në pjesë të madhe janë jashtë përdorimit për shkak se janë të vjetruara. Mësimdhënësit dhe nxënësit radhitën shumë përparësi të kabinetit si: konkretizimi i aspektit teorik, mundësia më e lartë për eksperimentim, nivel më i lartë i bashkëpunimit dhe ndërveprimit në mes nxënësve dhe mësimdhënësve etj. Hulumtimi tregoi gjithashtu se kabinetet ka ndikuar në përmirësimin e shumë aspekteve të të nxënësve në lëndën e Gjeografisë.

Fjalët kyçe: kabinetet, Gjeografia, nxënësi, pajisjet, veglat

Kandidati/ja: 4. Arbenita Rushiti

Tema: Ndikimi i argumentimit të zgjidhjeve të detyrave për përmirësimin e arritjeve të nxënësve në lëndën e matematikës

ABSTRAKTI

Argumentimi është proces i arsytimit i cili përdoret për të mbrojtur dhe bindur të tjerët se pohimi ynë është i saktë. Duke pas parasysh se argumentimi në matematikë është një nga proceset më të rëndësishme, në këtë hulumtim është analizuar aftësia e nxënësve të nivelit të arsimit të mesëm të lartë për të arsyetuar dhe argumentuar zgjidhjet e detyrave matematikore. Poashtu, është analizuar ndikimi i këtyre argumentimeve në arritjet e nxënësve në matematikë.

Hulumtimi është hulumtim në veprim bashkëpunues. Dizajni kuazi-eksperimental dhe metoda cilësore për të analizuar vëzhgimet dhe diskutimet gjatë argumentimeve, ka mundësuar të shqyrtohet më thellësisht ndikimi i argumentimit në përmirësimin e aftësive të nxënësve për zgjidhjen e detyrave nga matematika. Instrumentet që janë përdorur janë para dhe pas testi, vëzhgimi me pjesëmarrje dhe audio regjistrimet. Nxënësit e klasës eksperimentale kanë marrë udhëzime në lidhje me argumentimet për atë se kur është argumentimi bindës dhe i plotë. Të gjitha argumentimet e nxënësve për zgjidhjen e detyrave matematikore janë analizuar me anë të modelit të Toulmin-it.

Audio regjistrimet e nxënësve të përfshirë në diskutime gjatë intervenimit dhe analiza interpretative e tyre kanë treguar se diskutimet në klasë forcojnë zhvillimin e aftësive të nxënësve për të argumentuar. Gjetjet e bëra në këtë hulumtim kanë ofruar informata për nivelin e argumentimit të nxënësve, ndërkaq është treguar se nxitja e nxënësve për të diskutuar e argumentuar në klasë ka ndikim të madh në përmirësimin dhe arritjet e nxënësve në lëndën e matematikës.

Fjalët kyçe: argument, argumentim, diskutim, modeli Toulmin.

Kandidati/ja: 5. Hava Ibrahim

Tema: Aplikimi i metodës tradicionale dhe i matematikës realiste në mësimdhënien e sistemeve të ekuacioneve lineare me dy të panjohura

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij studimi është të hulumtohen efektet e mësimdhënies së sistemeve të ekuacioneve lineare me dy të panjohura me metodën e matematikës realiste në arritjet e nxënësve të klasës së nëntë në krahasim me metodën tradicionale. Vështirësitë në mësimin e algjebër kanë mbetur të jenë probleme që kurrikulat aktuale nuk arrijnë t'i zgjidhin. Ky studim promovon matematikën realiste si metodë e të mësuarit për të ndihmuar nxënësit në zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve lineare.

Hulumtimi për këtë temë është realizuar me nxënësit e dy klasave të nënta në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (SHFMU) “28 Nëntori” në Brodosanë, Dragash. Derisa qëllimi i këtij hulumtimi është konfirmimi i hipotezës së këtij studimi që është se mësimdhënia e sistemeve të ekuacioneve lineare me dy të panjohura me metodën e matematikës realiste, ka efekt pozitiv në motivimin e nxënësve të klasës së nëntë në zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve lineare me dy të panjohura.

Fjalët kyçe: Ekuacionet lineare, sistemet e ekuacioneve lineare, metoda tradicionale, metoda bashkëkohore, matematika realiste.

Kandidati/ja: 6. Fitore Kryeziu

Tema: Qëndrimet e nxënësve mbi formën individuale të mësimit në përvetësimin e përmbajtjeve në lëndën e biologjisë

ABSTRAKTI

Me *formën individuale* nënkuptojmë organizimin e mësimit vetëm me një nxënës, ku vijnë në shprehje aftësitë, shkathtësitë dhe shprehitë e nxënësit. Përmes mësimit të individualizuar zhvillohen prirjet, talenti, personaliteti vetanë i nxënësve. Puna individuale vjen në shprehje më shumë gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të konstatojmë rëndësinë e formës individuale të punës mësimore që përdoren në mësimdhënien e lëndës së biologjisë. Hulumtimi është realizuar përmes pyetësorëve që është një teknikë e përshtatshme për grumbullimin e të dhënave dhe për nxjerrje të rezultateve të përgjithshme. Hulumtimi përfshin pyetësorë për mësimdhënës që përmban 15 pyetje dhe pyetësorë për nxënës që përmban 20 pyetje. Për hulumtimin e kësaj dukurie kemi përdorur metodat sasimore dhe cilësore, të cilat na mundësojnë t'i grumbullojmë të dhënat, analizojmë, krahasojmë dhe të tregojmë nivelin e këtij hulumtimi më konkret. Hulumtimi është kryer me nxënës të klasave VIII dhe IX dhe me mësimdhënës të lëndës së biologjisë në tri shkolla të mesme të ulëta në komunën e Malishevës: ShFMU "Vesël Pagarusha" në Pagarushë, ShFMU "Gjergj Fishta" në Senik dhe ShFMU "Ibrahim Mazreku" në Malishevë. Për mbledhjen e informatave rreth kësaj forme kam përdorur literaturë vendore dhe të huaj bashkëkohore. Teknikat e përdorura për zhvillimin e formës individuale në lëndën e biologjisë shërbejnë për zhvillimin e aftësive bashkëpunuese, sociale dhe zhvillimin e të menduarit kritik dhe kreativ tek nxënësit. Rezultatet e pritura të këtij hulumtimi janë: të identifikojë problemet që paraqiten gjatë përdorimit të formës individuale, si dhe do t'i identifikojnë anët pozitive të formës individuale në lëndën e biologjisë. Detyrat e parashtruara për këtë hulumtim janë: hulumtim, analizë e shkaqeve ekzistuese dhe propozim.

Fjalët kyçe: Format e punës, mësimdhënia, teknikat, rezultatet.

Kandidati/ja: 7. Xhevrie Kurteshi

Tema: **Ndikimi i metodës së demonstrimit në të nxënit e lëndës së biologjisë**

ABSTRAKTI

Një ndër pikat kryesore të të nxënit të biologjisë është edhe demonstrimi i njohurive të mësuara. Kjo synon të thellojë të nxënit e nxënësve në lëndën e biologjisë. Qëllimi i këtij punimi është hulumtimi i rëndësisë së aplikimit të metodës së demonstrimit në lëndën e biologjisë dhe si kjo metodë ndikon në përfitimin e shkathtësive në këtë lëndë.

Duke pasur parasysh rëndësinë të cilën e ka kjo metodë më ka shtyrë që ta realizoj këtë hulumtim. Hulumtimi u realizua në SHMU “Bafti Haxhiu” dhe SHMU “Dëshmorët e Vitisë” në komunën e Vitisë. Metodologjia e cila është përdorur në këtë studim është sasiore dhe cilësore. Të dhënat u siguruan me ndihmën e teknikave hulumtuese siç janë: sondazhi, intervista, analiza dhe sinteza. Për të mbledhur të dhënat janë përdorur instrumentet siç janë: pyetësorët për sondazh, si dhe protokollet për intervista individuale. Pjesëmarrës në këtë hulumtim ishin 204 respondentë (nxënës)si dhe disa mësime të mësuara.

Në këtë punim do të kemi synuar t’i përgjigjemi disa pyetjeve si : - Sa aplikohet metoda e demonstrimit ? - Sa ndikon kjo metodë në të përfitimin e shkathtësive në lëndën e biologjisë tek nxënësit e shkollave të mesme të ulëta?

Në bazë të rishikimit të literaturës do të ndërtohen edhe hipoteza kryesore si vijon: “ Metoda e demonstrimit aplikohet mjaftushëm në lëndën e biologjisë dhe kjo metodë ka ndikim pozitiv në të nxënit e shkathtësive në lëndën e biologjisë “ .

Në fund të këtij hulumtimi nga rezultatet e marra mund të konstatojmë se metoda e demonstrimit përdoret mjaftushëm nga ana e mësime të mësuara në orën e lëndës së biologjisë dhe se kjo metodë ka ndikim pozitiv në përfitimin e shkathtësive nga ana e nxënësve. Të njëjtën gjë e pohojnë edhe mësime të mësuara të cilët theksojnë se metoda e demonstrimit ngjallë interes nga ana e nxënësve dhe se nxënësit përfitojnë shkathtësi më të mëdha gjatë përdorimit të kësaj metode.

Fjalët kyçe: Biologji, demonstrim, nxënie, nxënës, mësime të mësuara.

Kandidati/ja: 8. Besnik Latifi

Tema: Aplikimi i softuerëve "Open Source" për përfitimin në të nxënit në shkollat e mesme të Prishtinës

ABSTRAKTI

Ky hulumtim ka për qëllim të hetojë se sa aplikohen softuerët "open source" për përfitimin në të nxënit në shkollat e mesme të Prishtinës.

Duke marrë parasysh faktin që TIK-u është qelës i zhvillimeve të shumta globale të mësuarit në shkolla nuk mund të plotësoj kërkesat aktuale vetëm përmes librave shkollore medoemos duhet të aplikojmë inovacione të teknologjisë aktuale. Një ndër to janë softuerët open source të cilët ofrojnë një mundësi të mirë për të mësuar gjëra të reja duke përgatitur nxënës të gatshëm për jetë dhe punë.

Metodologjia e hulumtimit është e përzier (kualitative dhe kuantitative), pyetëtori me nxënës është instrumenti i mbledhjes së të dhënave sasiore dhe intervista me mësimdhënës për mbledhjen e të dhënave cilësore.

Hulumtimi është realizuar në tri shkolla te komunës se Prishtinës, në gjimnazin “Sami Frashëri”, në gjimnazin filologjik “Eqrem Çabej” dhe në shkollën teknike “28 Nëntori”. Pjesëmarrës në hulumtim janë katër paralele të klasëve të dymbëdhjeta nga të tri shkollat, mostra përbëhet nga 118 nxënës nga shkolla “Sami Frashëri”, 115 nxënës nga shkolla “Eqrem Çabej” dhe 120 nxënës nga shkolla “28 Nëntori”. Gjithashtu për mbledhjen e të dhënave cilësore është realizuar intervista me 5 mësimdhënës të lëndës së TIK-ut.

Pyetja kryesore e hulumtimit është: *Sa aplikohen softuerët open source në shkollat e mesme të komunës së Prishtinës dhe cili është roli i aplikimit të këtyre softuerëve në të nxënit e nxënësve?*

Hipoteza e hulumtimit është: *Aplikimi i softuerëve open source ndikon pozitivisht në të nxënit e lëndës dhe rritë interesimin e nxënësve për mësim duke kontribuar kështu në formimin e individëve të gatshëm për jetë dhe punë.*

Nga gjetjet e hulumtimit del se këta softuer ende nuk gjejnë shumë zbatim në shkollat e anketuara me përjashtim të mësimit në distance ku si shkak i pandemisë shkollat e kishin te domosdoshme përdorimin e softuerëve dhe platformave të ndryshme free and open source.

Fjalët kyçe: mësimdhënia, softuerët open source, shkolla, TIK.

Kandidati/ja: 9. Doruntina Luta

Tema: Roli i eksperimentit virtual në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në lëndën e Teknologjisë në Shkollat e mesme të ulta

ABSTRAKTI

Studimi i këtij hulumtimi ka për qëllim që të analizoj situatën aktuale të përdorimit të eksperimentit virtual nga ana e mësimdhënësve dhe aktivitetet e nxënësve duke shfrytëzuar eksperimentet virtuale në orën mësimore. Po ashtu, do të shqyrtohen efektet e përdorimit të eksperimenteve dhe lehtësimi i të nxënësve tek nxënësit dhe mënyra e vlersimit të nxënësve në bazë të përdorimit të eksperimentit.

Përdorimi i kompjuteve në arsim është rritur shumë në vitet e fundit dhe tani kompjuteret dhe teknologjitë e ngjajshme janë në shumicën e shkollave ku edhe mundësohet zëvendësimi i eksperimenteve të ndryshme nga ato fizike në virtuale. Po ashtu, lehtëson edhe mësimin nga distanca duke ju lejuar nxënësve të shohin dhe prekin atë qfarë kanë mësuar.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi ka për bazë eksperimentin virtual me theks të veçantë të **PhET Colorado** dhe përdorimin e tij në SHMU-të në Kaçanik. Me këtë hulumtim synojmë të identifikojmë nivelin e përdorimit të eksperimenteve laboratorike nga mësimdhënësit dhe në qfarë mënyre ndikon në ngritjen e cilësisë në procesin mësimor. Po ashtu, presim të shohim se si nxënësit ndikohen dhe stimulohen nga përdorimi i eksperimentit virtual në procesin e të nxënësve.

Hulumtimi është realizuar në dy shkolla të mesme të ulta në Kaçanik. Hulumtimi ka për bazë vëzhgimin e drejtpërdrejtë në orën e teknologjisë dhe në pyetësorët dhe intervistat me nxënësit dhe mësimdhënësit të shkollave të mesme të ulta “Emin Duraku” dhe “Idriz Seferi” në Kaçanik. Dizajni i hulumtimit është kuazi eksperimental, me metoda të përziera (sasiore dhe cilësore) dhe është realizuar me katë klasë të shtata (si mostra të qëllimshme), ku dy klasë kanë rolin e grupit eksperimental kurse dy tjetra kanë rolin e grupit të kontrollit. Si instrumente të mbledhjes së të dhënave kemi përdorur dy teste (paratesti, pastesti), një pyetësor për nxënësit e targetuar si dhe intervistimi i mësimdhënësve.

Nga hulumtimi kemi nxjerrur rezultate se përdorimi i eksperimentit virtual në procesin e mësimdhënies dhe nxënësve ka efekt jashtëzakonisht të mirë dhe sjellë rezultatet pozitive në procesin mësimor.

Fjalët kyçe: *eksperiment virtual, mësimdhënie, mësimnxënie, PhET, nxënësit*

Kandidati/ja: 10. Emire Biçkaj

Tema: **Ndikimi i mësimi virtual në motivimin e nxënësve për punë të pavarur**

ABSTRAKTI

Sot, përdorimi i teknologjisë në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve është bërë i pashmangshëm. Edhe sipas Kornizës Kurrikulare të Kosovës, shfrytëzimi i teknologjisë është një nga kompetencat kryesore që duhet të zotërojë çdo nxënës. Kështu ky hulumtim ka për qëllim të shqyrtojë ndikimin e shfrytëzimit të teknologjisë përmes mësimi virtual për të ngritur motivimin e nxënësve për punë të pavarur. Në veçanti, hulumtimi shqyrton angazhimin e nxënësve në kryerjen e detyrave të shtëpisë, duke përdorur platformën Khan Akademi dhe qëndrimet e nxënësve rreth tyre. Ky hulumtim u mbështet në një skemë të modifikuar të disa teknikave që duhen realizuar gjatë përdorimit të teknologjisë në edukim, të cilat mbështeten në parimet e bihejvioristëve dhe kanë për qëllim përfundimin e sjelljes së nxënësve kundrejt punës së pavarur, gjegjësisht kryerjes së detyrave të shtëpisë.

Në këtë hulumtim në veprim bashkëpunues morën pjesë 20 nxënës të klasave të teta të një shkolle të mesme të ulët të komunës së Ferizajit. Instrumentet e përdorura ishin ditari personal i mësimdhënësit, pyetësi dhe monitorimi në distancë i mundësuar nga klasat virtuale të Khan Akademi. Duke konsideruar se hulumtimi nuk kishte të bënte me shqyrtimin saktësisë së detyrave, por kishte të bënte me analizën e kohës që nxënësit e kalojnë duke u angazhuar me detyra të shtëpisë, mund të konkludojmë se, mësimi virtual ka ndikuar që të gjithë nxënësit të jenë të angazhuar me detyra, të paktën, katër herë më gjatë periudhës së intervenimit. Po ashtu, nga analiza e kohës që nxënësit e kalojnë për të përfunduar detyrat e shtëpisë, gjetjet tregojnë se mësimi virtual ka bërë që nxënësit të kursejnë kohën që u duhet për kryerjen e detyrave të shtëpisë.

Hulumtimi tregon se shfrytëzimi i klasave virtuale të Khan Akademisë ka ndikuar edhe në qëndrimet e nxënësve për punë të pavarur. Kështu, nga të dhënat përfundimtare arrijmë të shohim një ngritje të përqindjes në qëndrimet pozitive të nxënësve dhe një ulje të përqindjeve në qëndrimet negative të nxënësve rreth punës së pavarur. Nxënësit janë shprehur se janë ndier të motivuar për punë të pavarur, si shkak i llojeve të ndryshme të detyrave, i informatave kthyesë dhe rezultateve të drejtpërdrejta të detyrave.

Fjalët kyçe: *punë e pavarur, mësim virtual, monitorim në distancë, motivim*

Kandidati/ja: 11. Amir Gashi

Tema: Qëndrimet e nxënësve të klasave të XI-ta për efikasitetin e mësimit online në lëndën e Biologjisë gjatë pandemisë Covid-19

ABSTRAKTI

Mësimi në distancë është formë e arsimit e cila realizohet përmes teknologjive moderne të komunikimit me qëllim të arsimit të nxënësve që jetojnë në vende me largësi të ndryshme jashtë ambientit tradicional të mësimit (klasës). Përderisa mësimi në distancë i referohet përvojës së të mësuarit zyrtar ose jozyrtar, edukimi në distancë nënkupton veçanërisht udhëzimin zyrtar të realizuar nga një mësues që planëzon, orienton dhe në fund e vlerëson procesin e të mësuarit. Si pasojë e pandemisë me virusin Korona shumë vende në botë përfshirë edhe Kosovën kanë përdorur forma të ndryshme të mësimit në distancë në sistemin e tyre të edukimit. Mbyllja totale dhe kalimi “rapid” prej formës tradicionale të mësimdhënies në klasa në mësim në distancë pa një fazë tranzitore ka sfidat dhe peripecitë e veta sidomos për nxënësit dhe mësime të mësimit në distancë përmes platformave e-learning. Andaj edhe ky hulumtim i jep përgjigje pyetjes se si ndikon forma e mësimdhënies përmes platformave online në suksesin e të nxënësve të nxënësve në lëndën e Biologjisë dhe cilat janë sfidat dhe problemet që kanë hasur nxënësit në të nxënësve të lëndës së Biologjisë në krahasim me format tradicionale të punës në klasa. Hulumtimi është kryer me anë të metodave sasimore ku si teknikë e hulumtimit është përdorur pyetësi. Në rastin tonë si mostër janë hulumtuar qëndrimet e nxënësve të gjimnazit “Ulpiana” Lipjan në hulumtimin morrën pjesë 300 nxënës të klasave të XI-ta, ku përmes qëndrimeve të tyre do vlersohen sfidat, të metat, përparsitë e formës së mësimit online. Mbledhja e të dhënave është bërë me anë të pyetësorit i cili është i formuluar nga pyetje të mbyllura. Rezultatet tregojnë për shkallë të ulët të ndikimit të pandemisë dhe rrjedhimisht të mësimit online në suksesin e nxënësve në krahasim me suksesin gjatë mësimit tradicional në klasa fizike si dhe mësimi online cilësohet si metod jo praktike, jo e preferueshme dhe jo efektive e të nxënësve të lëndës së Biologjisë.

Fjalët kyçe: Biologjia, COVID-19, mësimdhënia në distancë, nxënësit, teknologjia

Kandidati/ja: 12. Arian Arifi

Tema: Ndikimi i teknologjisë informative ne përvetësimin e të nxënit në lëndën e Gjeografisë

ABSTRAKTI

Në këtë studim, hulumtohet ndikimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në përvetësimin e të nxënit në lëndën e Gjeografisë. Mostër e studimit janë 100 nxënës të katër shkollave të mesme të ulëta në Komunën e Gjilanit si dhe 7 mësimdhënës të lëndës së Gjeografisë të katër shkollave në fjalë. Mostra sa i përket shkollave pjesëmarrëse u përzgjedh me metodën e qëllimshme me kriter numrin e nxënësve, infrastrukturën dhe vendndodhjen. Mostra për nxënësit dhe mësimdhënësit u përzgjedh me metodën e rastësishme. Studimi është i natyrës mikse (kualitative dhe kuantitative) dhe dy instrumentet e përdorura janë pyetësorët dhe intervistat gjysmë të strukturura. Pyetjet e pyetësorit janë të vetë-dizajnuara, me fund të mbyllur, të cilat u aplikuan me nxënës ndërsa pyetjet e intervistave janë me fund të hapur, të aplikuara ndaj mësimdhënësve të Gjeografisë.

Rezultatet e hulumtimit treguan se TIK ka ndikuar pozitivisht në të nxënit e nxënësve duke zhvilluar aftësitë e tyre njohëse, kërkuese/eksperimentale, ka rritur motivimin e tyre për punë, ka rritur angazhimin në klasë si dhe bashkëpunimin mes nxënësve. Nxënësit janë pajisur me informacion të azhurnuar dhe kanë zhvilluar aftësitë hapësinore përmes përdorimit të programeve softuerike si Google Earth, National Geographic etj. Nxënësit gjithashtu kanë arritur të përmirësojnë rezultatet e tyre në lëndën e Gjeografisë.

Rezultatet e hulumtimit e vërtetuan hipotezën se *Përmes përdorimit të TIK nxënësit kanë rezultate më të mira në lëndën e Gjeografisë*. Rezultatet e hulumtimit treguan se mjetet teknologjike që përdoren më shumë prej mësimdhënësve në klasë janë laptopi, video-projektori dhe tabelat interaktive ndërsa programet softuerike më të përdorura nga Google Earth, Google Lit Trips, Monstessorium: Intro to Geo. Një pjesë e mësimdhënësve gjithashtu përdorin sisteme elektronike për menaxhimin e nxënësve si Classroom dhe Schoology. Rezultatet treguan se mësimdhënësit kanë pak njohuri për Taksonominë Digjitale dhe Blumit dhe nuk e zbatojnë sa duhet atë në klasë. Gjithashtu, dy sfidat dhe vështirësitë kryesore të mësimdhënësve sa i përket integritit të TIK në klasë ishin mungesa e infrastrukturës (kabinetet dhe mjetet teknologjike) dhe mungesa e trajnimeve për aftësim profesional në fushën e TIK.

Fjalët kyçe: TIK, Gjeografia, përvetësimi, të nxënit, mjetet, programet softuerike

Kandidati/ja: 13. Gentiana Nebihu

Tema: Strategjitë e mësimdhënies që kontibuojnë në zhvillimin e kompetencës së të menduarit tek nxënësit dhe sfidat në zhvillimin e saj

ABSTRAKTI

Përmes këtij hulumtimi synojmë identifikimin e strategjive bashkëkohore të mësimdhënies të cilat kontribojnë në zhvillimin e kompetencës së të menduarit të nxënësve, si një nga kompetencat kyçe të kurrikulës së re.

Shkolla bashkëkohore kërkon nga mësimdhënësit që si faktor subjektivë në procesin mësimor t'i kultivojnë tek nxënësit shprehitë e të menduarit kritik dhe krijues. Padyshim, që në këtë drejtim mësimdhënësve iu ndihmojnë strategjitë bashkëkohore të mësimdhënies. Gjatë zbatimit të këtyre strategjive, mësimdhënësit ballafaqohen me sfida të shumta, prandaj që të arrijmë qëllimin e këtij studimi, kemi analizuar literaturë shkencore vendore dhe ndërkombëtare në mënyrë që të njihemi më gjerësisht me problematikën tonë të hulumtimit.

Për realizimin e këtij studimi është përdorur metodologjia mikse e kërkimit, ku kemi kombinuar qasjen cilësore me atë sasiore në mënyrë që t'i përgjigjemi pyetjeve të hulumtimit që kemi ngritur.

Të dhënat sasiore në këtë hulumtim janë mbledhur përmes pyetesorit, kurse për mbledhjen e të dhënave cilësore është shfrytëzuar intervista gjysmë e strukturuar. Të dhënat sasiore janë analizuar dhe përpunuar përmes programit aplikativ SPSS, ndërsa për të dhënat e natyrës cilësore është bërë analiza tematike e tyre.

Ky hulumtim u realizua në komunën e Prishtinës, responentë në hulumtimin tonë janë mësimdhënësit e gjeografisë që zhvillojnë procesin mësimor në klasët ku është duke u zbatuar kurrikula e re, respektivisht në klasët VI, VII dhe VIII. Në këtë studim morën pjesë gjithsej 40 subjekte hulumtuese.

Nga rezultatet e fituara në këtë studim, mund të konstatojmë se mësimdhënësit i vlerësojnë pozitivisht strategjitë bashkëkohore të mësimdhënies, pjesa dërmuese e tyre theksuan se zbatojnë strategjinë e të pyeturit, të diskutimit, strategjinë e bazuar në zgjidhjen e problemeve etj. Kurse sa i përket sfidave që ballafaqohen mësimdhënësit në zhvillimin e kompetencës së të menduarit të nxënësve ata theksuan numrin e madh të nxënësve, tekstet mësimore të paharmonizuara me nevojat e kurrikules së re, mungesa e trajnimeve dhe mjeteve të konkretizimit.

Fjalët kyçe: *Kompetencë, mendim kritik, strategji të mësimdhënies, sfida.*

Kandidati/ja: 14. Lediana Shala

Tema: Përdorimi i veglës Pear Deck për realizimin e prezantimeve interaktive në lëndën e Teknologjisë

ABSTRAKTI

Ky punim ka për qëllim të shqyrtojë ndikimin dhe përparësitë e përdorimit të aplikacionit Pear Deck në realizimin e një ore mësimore. Fokusi i këtij hulumtimi është përdorimi i teknologjisë Pear Deck për krijimin e prezantimeve interaktive të cilat ju lejojnë nxënësve të bashkëveprojnë me prezantimin gjatë orës mësimore, të punojnë në mënyrë të pavarur si dhe të përgjigjen në pyetje të ndryshme që parashtrihen nga këto sllajde interaktive.

Në hyrje të këtij hulumtimi është dhënë një pasqyrë mbi rëndësinë e përdorimit të veglës Pear Deck në procesin e mësimdhënies, ndërsa në pjesën e shqyrtimit të literaturës janë vënë në pah publikimet dhe botimet e ndryshme shkencore të cilat theksojnë rëndësinë e përdorimit të veglave teknologjike dhe prezantimeve interaktive në klasë. Tek kapitulli i metodologjisë është përshkruar në detaje metodologjia e përdorur për të finalizuar këtë hulumtim kurse përmes kapitullit të analizës së të dhënave, janë përshkruar metodat e përpunimit të të dhënave dhe të paraqitjes së tyre. Përfundimisht, në pjesën e konkludimit, janë nxjerrë përfundimet e përmbledhura pas kryerjes së hulumtimit.

Dizajni i hulumtimit është kuazi eksperimental, me metoda të përziera (sasiore dhe cilësore) dhe është realizuar me dy klasë të shtata në shkollën fillore të mesme të ulët “Naim Frashëri” në Prishtinë (si mostra të qëllimshme), ku njëra ka rolin e grupit eksperimental kurse tjetra ka rolin e grupit të kontrollit. Si instrumente të mbledhjes së të dhënave janë përdorur dy teste (paratesti, pastesti), një pyetësor për nxënësit e klasës eksperimentale si dhe metoda e vëzhgimit në të dy klasët. Me anë të të dhënave të fituara përmes pyetësorit, janë matur efektet pozitive në motivimin e nxënësve për të mësuar, efektet pozitive në arritje janë matur me anë të testimit të nxënësve të të dy grupeve, kurse me anë të listës së kontrollit janë reflektuar qëndrimet si mësimdhënëse gjatë procesit të vëzhgimit.

Rezultatet e këtij studimi, kanë treguar se përdorimi i veglës Pear Deck ndikon pozitivisht në mbamendjen, motivimin dhe interesimin e nxënësve për të mësuar dhe se kjo vegël është më efiikase për përdorim gjatë orës mësimore në krahasim me metodat tradicionale të të mësuarit.

Fjalët kyçe: *Interaktivitet, motivim, paratest, pastest, Pear Deck.*